

VENDIM
Nr. 403, datë 3.6.2026

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS TEK DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, TË PASURISË SË PALUAJTSHME NR. 7/39-N5, ZONA KADASTRALE 8542, GJIROKASTËR, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të pasurisë nr. 7/39-N5, zona kadastrale 8542, Gjirokastrë, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ushtrimin e aktivitetit administrativ.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ia japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Planimetria e zyrrave aktuale DV ASHK Gjirokastër

Sipërfaqja totale S=209 m²

Architectural floor plan of the DV ASHK Gjirokastër building. The plan shows a complex layout with multiple rooms and corridors. Key dimensions are labeled: a large room on the right is 500m wide and 700m deep; a central corridor is 1.50m wide; a small room is 1.10m wide; and the overall building dimensions are 2220m by 1450m. The total area is S=209 m².

SUPERFAQJA TOTALE=200 m2

A SH K	Objekti:	PLANIMETRIA E ZYRAVE AKTUALE DV ASHK GJIROKASTËR	DVASHK/ZVASHK:	Vula:
			GJIROKASTER	
Nr. fletes:	Emertimi i fletes:		Përditësoi në terren:	Nënshkrimi:
A - 1	PLANIMETRIA E KATIT PERDHE		BASHKIM ALLARAJ	 Bashkim Allaraj
Shkalla:	Pronari/Administratori:		Punoi në zyrë:	Nënshkrimi:
1 : 100	ASHK		ALBAN BUKAÇI	 Alban Bukaçi
Data e Përfundimit:				
22.04.2026				